

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë zhvilluan një aktivitet shkencor me temë "Zhvillimi i letërsisë dhe gjuhës shqipe nëpërmjet krijimtarisë së shkrimtarëve".

Ky aktivitet kishte për qëllim vlerësimin e kontributeve të jashtëzakonshme të figurave të shquara të kulturës dhe letrave shqipe, personalitete që, përmes veprës së tyre, kanë ndihmuar në formësimin e standartit të gjuhës dhe në pasurimin e trashëgimisë sonë kulturore.

Në këtë aktivitet u prezantuan studime dhe reflektime mbi rolin e shkrimtarëve shqiptarë si mësues të kulturës gjuhësore dhe krijues të fjalës artistike, duke theksuar rëndësinë që ka ruajtja e kësaj trashëgimie për brezat e ardhshëm.

